

JENS REUTER

**POLITIKA E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË
NË VITET NËNTËDHJETË**

Humbje rastesh

Bashkësia ndërkombëtare, Bashkimi Evropian dhe ShBA, kanë humbur rastin që të vinin në rendin e ditës problemin e Kosovës, kur ishte pjekur koha për një gjë të tillë. Në konferencat kushtuar Jugosllavisë, që filluan në Hagë në vitin 1991 dhe mbaruan në Deiton, ky problem u kthye sërish. Bashkësia ndërkombëtare shihte si të vendosur një herë e përgjithmonë faktin që Jugosllavia, sipas Kushtetutës Federale në fuqi të vitit 1974, përbëhej jo nga shtatë, por nga tetë njësi kushtetuese. Dy provincat autonome, Kosova dhe Vojvodina, në fakt i viheshin të shtatë republikave si të barabarta. Edhe ato kishin të drejtë vetoje për legjislacionin dhe gëzonin të drejtën e rotacionit në postin e presidentit të shtetit jugosllav dhe të kryetarit të partisë në rrafshin federativ. Në vitin 1991, Komisioni i Arbitrazhit i Bashkësisë Evropiane për sqarimin e pasardhjes shtetërore në Jugosllavi, nën kryesinë e Robert Badinter, nuk i njohu provincat autonome të Kosovës dhe Vojvodinës si pjesë sovraane të Federatës. Rrjedhimisht, nuk u njohu atyre të drejtën për të formuar një shtet të tyre. Ky nuk ishte një gabim i ekspertizës juridike. Komisioni, që në fillim, kishte vetëm detyrën që të verifikonte e të kontrollonte marrëdhëniet në Jugosllavi.

Në fund të viteve tetëdhjetë, Slllobodan Millosheviçi i kishte marrë Kosovës autonominë. Provinca, me shkeljen e Kushtetutës Jugosllave që degraduar në fakt në gjendjen e një rajoni pa të drejta në Jugosllavi, kurse popullsia shqiptare i qe nënshtruar një shtypjeje brutale. Bashkësia Evropiane dhe ShBA e kanë pranuar në heshtje këtë grusht shteti, sepse ata e konsideruan Kosovën si pjesë të Serbisë, pa të drejta për veprime në shkallë ndërkombëtare. Në fillim të vitit 1992, diplomatët perëndimorë e kanë argumentuar këtë qëndrim si vijon: u desh që serbëve t'u kërkoheshin sakrificat të konsiderueshme në Kroaci e në Bosnje, prandaj

do të ishte e pamundur që prej tyre të kërkohej të hiqnin dorë edhe nga Kosova. Në këtë kohë, qarkulluan fjalë se Perëndimi kishte përfunduar një marrëveshje të rregullt me Millosheviçin. Për miratimin e dhënë për vendosjen e helmetave blu në Krajna, presidenti i atëhershëm i Serbisë kishte marrë premtimin që problemi i Kosovës të mos shtrohej në rendin e ditës.

Kështu, çështja e Kosovës nuk u ndërkombëtarizua dhe nuk u trajtua si problem i vetëvendosjes së popujve (krahaso në lidhje me këtë, artikullin e Georg Brunner mbi të drejtën e popujve dhe të drejtën e vetëvendosjes në Kosovë). Por Bashkësia Ndërkombëtare nuk ishte gati t'u jepte shqiptarëve të Kosovës të drejtën që ua kishte dhënë me gjithë qejf sllovenëve dhe kroatëve, atë të shkëputjes nga Jugosllavia.

Në vitin 1991 parlamenti jozyrar i shqiptarëve të Kosovës shpalli shtetin e pavarur të Kosovës. Ky “shtet” u njoh vetëm nga parlamenti i Tiranës. Të gjitha shtetet e tjera të botës e injoruan “Republikën e Kosovës”. Në deklaratën e Lisbonës (qershor 1992), Këshilli Evropian foli vetëm për “aspiratat legjitime të banorëve të Kosovës për autonomi, që duhet të trajtoheshin në kuadrin e një konference për Jugosllavinë. Deklarata e Edinburgut (dhjetor 1992) kërkonte që të rivendosej “autonomia e Kosovës brenda Serbisë”¹. Këtu dolën për herë të parë nga fjalori koncepte që më vonë do të ishin thelbësore për fillimin e zgjidhjes së çështjes nga BE: “dialog” dhe “masa që krijojnë besim”. Dobësia e këtyre koncepteve qëndronte në faktin se kosovarët duhet të kërkonin dialogun me një politikan, i cili në vitin 1989 iu kishte marrë atyre me dhunë autonominë dhe që kishte përgjegjësi vetjake për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë. Masat që krijojnë besim, sidoqoftë, do të mund të mendoheshin, sikur opozita serbe, në fund të vitit 1996, t'ia kishte arritur të përmbyste Millosheviçin, por kjo kërkesë në vitet në vijim dilte si një anakronizëm.

Përpjekjet e Bashkimit Evropian pas vitit 1992 kishin si qëllim që të pengonin përdorimin e dhunës dhe shpërthimin e veprimeve armiqësore në Kosovë. Politika e padhunshme e shpallur nga Ibrahim Rugova dhe shteti shqiptar në hije që u krijua nën udhëheqjen e tij, gjetën kudo në botën perëndimore mbështetje morale. Por Rugova nuk duhet në

¹ S. Troebst, *Conflict in Kosovo: failure of prevention? An analytical documentation, 1992-1998*, Flensburg, 1998 (ECMI Working Papers, 1, maj 1998), f.49.

asnjë mënyrë të trajtohet si “Gandi i Ballkanit”. Në vitin 1991 ai i deklaroi autorit të këtij shkrimi: “Ne nuk jemi aspak pacifistë. Ne thjesht nuk kemi armë të mjaftueshme dhe për këtë arsye nuk duhet të arrijmë deri në përdorimin e armëve”.

Politika e presidentit jozyrtar të kosovarëve i erdhi shumë e volitshme Perëndimit. Ajo mbajti të qetë mbi shtatë vjet një krahinë që gjithmonë është cilësuar si vatër lufte. Në këtë kohë Rugova u përpoq me këmbëngulje për ndërkombëtarizimin e problemit të Kosovës. Por udhëtimet e tij në vendet e rëndësishme të BE, sidoqoftë, mbetën pa rezultate të dukshme. Kudo ai u ndesh me mirëkuptim dhe me mbështetje, por kërkesat e tij themelore nuk u përmbushën. Nuk pati kurrfarë konferencë ndërkombëtare për Kosovën. Një protektorat për Kosovën nuk u mor asnjëherë në konsideratë. Ideja e një shteti të pavarur të Kosovës që fillimisht duket e matur, më vonë qe hedhur poshtë vrazhdësisht. Shpresat e Rugovës qenë asgjësuar dalëngadalë. “Kosova – fëmija i gjetur i Daytonit” ishte përcaktimi gazetaresk i faktit se konferenca e fundit dhe më e rëndësishme e Jugosllavisë e vitit 1995 nuk e përmendi Kosovën as dhe një herë të vetme.

Vendet e Bashkimit Evropian nuk qenë në gjendje të përpunonin e të zhvillonin një strategji dhe politikë të përbashkët për problemin e Kosovës. Në Bruksel, pas Konferencës së Deitonit, u ra dakort të normalizoheshin marrëdhëniet me Beogradin, pas përmirësimit thelbësor të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në shkurt të vitit 1996 Franca nxitoi të njëjtte RF të Jugosllavisë. Ka të ngjarë që Beogradi këtë hap ta kishte siguruar me traktativa të fshehta, që u zhvilluan në vitin 1993, me rastin e lirim të dy pilotëve të avionëve bombardues francezë. Britania e Madhe, Suedia, Danimarka, Vendet e Ulëta, Portugalia, Italia dhe Gjermania ndoqën shumë shpejt shembullin francez. Përsëri Bashkimi Evropian kishte dalë i paaftë për të bashkërenditur politikën e tij ndaj Beogradit dhe të kryente hapin e njohjes nën kushtet e caktuara bashkarisht. Parlamenti Evropian, duke iu referuar shkeljeve të vijueshme të të drejtave të njeriut në Kosovë, kritikoi anëtarët që e kishin njohur të parin Beogradin².

Në fund të tetorit të vitit 1995 dhe në prill të vitit 1996, Këshilli Evropian i drejtoi thirrje Beogradit, që t’i jepte Kosovës “një masë të lartë autonomie”. Ai u tregua “i shqetësuar thellësisht” për shkak të

² F. Schmidt, *Supporting the Status quo*, “War Report”, maj 1996, f.32.

gjendjes së njerëzve dhe të pakicave në RF të Jugosllavisë. Bashkimi Evropian nuk donte asnjë ndryshim të status quo-së territoriale në RF Jugosllave dhe shpalli rishtazi idetë e vjetra të “dialogut” dhe të “masave që krijojnë besim”. Por këtu ishte rreziku që të ngecje në një kurth të ndërtuar me duart e veta. Mbasi ta kishte njohur Kosovën si pjesë të Serbisë, (përkth. të Jugosllavisë), edhe problemi i Kosovës bëhej një çështje e brendshme e Jugosllavisë. Nëse kërkohej ndërkombëtarizimi i kësaj çështjeje, ashtu siç ishte, për shembull, inisiativa gjermano-franceze e vjeshtës së vitit 1997, duhej më parë të deklarohet se synohej drejt një përmirësimi të status quo-së në pikat e autonomisë, të të drejtave njerëzore dhe të të drejtave të pakicave. Kjo përjashtonte *a priori* opsionin e një shteti të pavarur të Kosovës. Udhëheqja jugosllave, shpjegimet dhe deklaratat e këtij lloji i interpretonte si të dobëta. Nëse Bashkimi Evropian pranonte si të drejtë dhe përfundimtare përkatësinë e Kosovës në Serbi, atëherë kërkesa për një përmirësim thelbësor në këtë krahinë mund të konsiderohej si një “përzierje në punët e brendshme” të Beogradit. Ministri i Punëve të Jashtme dhe më vonë presidenti i Serbisë, Milutinoviç, nuk pranoi inisiativën gjermano-franceze të vjeshtës së vitit 1997, qoftë edhe me fjalë. Ndërmjetësit e huaj po ndërhynin në punët e brendshme dhe kjo nuk mund të pranohej. Së fundi, Beogradi nuk i drejtoi as edhe një letër Parisit për shkak të gjendjes së krijuar në Korsikë.

Kur ministri i atëhershëm gjerman i Punëve të Jashtme dhe kolegu i tij francez Hubert Vedrine i bënin thirrje partive në Kosovë, gjithmonë për dialog dhe kompromis, ata linin jashtë vëmendjes një problem themelor. Pozitat e kundërshtarëve ishin diametralisht të kundërta. Një kompromis ishte i pamundur. Teorikisht qëndronte mundësia që shqiptarët të kënaqeshin me një shkallë të lartë autonomie brenda shtetit serb e që pala serbe t’ia ofronte menjëherë. Praktikisht, vetëm kjo nuk ishte e mundur. Autonomia në sytë e shqiptarëve nuk kishte vlerë derisa ushtria dhe policia serbe e kishin nënshtruar provincën dhe e kishte kthyer atë në një zonë të pushtuar. Njëkohësisht ishte e qartë se udhëheqja e Beogradit nuk do t’i largonte asnjëherë vullnetarisht nga Kosova forcat e saj të sigurimit, sepse një gjë e tillë do të konsiderohej nga shqiptarët si një ftesë për shpëputje.

Ndryshe nga shtetet e Bashkimit Evropian, ShBA nuk e kishte njohur RF të Jugosllavisë. Nuk kishte ambasada të ShBA në Beograd dhe, kur Uashingtoni shtetin e padëshiruar e quan me emër, flet

gjithmonë për “Serbinë e Malin e Zi”. Shtetet e bashkuara kanë mbështetur shprehimisht politikën jo të dhunshme të Ibrahim Rugovës. Ai ka qenë një mysafir relativisht i shpeshtë në Uashington, ku gjithmonë ka gjetur njohje dhe inkurajim. Për shkak të Kosovës, Uashingtoni, me ndihmën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ngriti të ashtuquajturin “mur të jashtëm” kundër Jugosllavisë së Re dhe e preu në këtë mënyrë nga tregu i kapitalit ndërkombëtar. Për shkak të Kosovës dhe të pastrimeve etnike, që potencialisht kërcënonin vendin, presidenti Bush i drejtoi në Krishtlindjet e vitit 1992 një mesazh konfidencial Sllobodan Millosheviçit. Ai kërcënonte me sulme ajrore të njëanshme të ShBA kundër objektivave strategjike në Serbi, nëse do të përparonte ushtarakisht në Kosovë. Ky paralajmërim u përsërit nga presidenti Klinton më 10 shkurt të vitit 1993. Në fillim të marsit të vitit 1998, i ngarkuari i veçantë i Uashingtonit, Gelbhard, shpjegonte se politike e ShBA nuk kishte ndryshuar dhe se tani presidenti do të merrte paralajmërimet korresponduese. Sekretarja në Departamentin Amerikan të Punëve të Jashtme, Albright, tha pak më vonë: “Ne nuk do të shikojmë në mënyrë pasive se si autoritetet serbe bëjnë në Kosovë atë që nuk janë më në gjendje ta bëjnë në Bosnjë³”.

Me gjithë këto fjalë të qarta, politika amerikane ndaj Kosovës mbeti kontradiktore. Ambasadori i posaçëm Gelbhard deklaroi se një shtet i pavarur i Kosovës nuk mund të pajtohej me politikën amerikane në Gadishullin Ballkanik. Njëkohësisht ai e cilësoi në fillim Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), krejt si pas frymës së Beogradit, si “terroriste”. Është e qartë se në Departamentin e Shtetit ishin të bindur se konflikti i Kosovës, së pari duhej përmbajtur, penguar, domethënë duhej ndaluar si një përmbajtje në vendet fqinje të Maqedonisë dhe të Shqipërisë dhe më pas, do të mund të vinin paqja dhe stabiliteti në Kosovë nëpërmjet një kompromisi të pranueshëm ndërmjet kundërshtarëve.

Aktivitetet e Grupit të Kontaktit

Grupi i Kontaktit që përbëhej nga Rusia, ShBA, Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Gjermania, mori në shqyrtim, në shtator të vitit 1997, problemin e Kosovës. Në frymën e deklaratave të mëparshme të BE ai i bëri thirrje palëve të armiqësuar për dialog, për të hequr dorë nga dhuna.

³ S. Troebst, *vep. e përm.*, f.49.

Këto kërkesa realiste u saktësuan më tej në Deklaratën e Moskës të shtatorit të vitit 1997. Sipas pikëpamjes së Grupit të Kontaktit nuk ishte e pranueshme as status quo-ja e pranishme me vulën e dhunës, as dhe kërkesa e palës shqiptare për pavarësi shtetërore. Në një përpjekje të sforcuar për maturi dhe drejtpeshim, në Deklaratën e Londrës të 9 marsit të vitit 1998, Grupi i Kontaktit dënoi si sjelljen brutale të forcave të sigurimit serb në Kosovë, po ashtu dhe aktet terroriste të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK. Bashkimi Evropian këmbënguli për sanksione të tjera kundër RF Jugosllave, duke injoruar kështu përvojën e viteve të mëparshme se sanksionet plotësuese nuk do të kishin ndikim tek Jugosllavia e shkatërruar ekonomikisht. Bllokimi i kredive dhe i borxheve të jashtme, ndalimi i investimeve në RF Jugosllave dhe ndalimi i fluturimeve me shoqërinë ajrore të fluturimeve JAT nuk patën asnjë efekt. Sanksionet, përkundrazi, funksionuan për të treguar se Bashkimi Evropian nuk qëndroi indiferent dhe se, siç e përsëritën gjithmonë e më shumë politikanë të shumtë – një Bosnje e dytë nuk do të pranohej⁴.

Në qershor të vitit 1998, presidenti Millosheviç udhëtoi për në Moskë. Në këtë kohë trupat e tij në Kosovë ishte në pozita mbrojtjeje. Ai vetë po i nënshtrohej një trysnie të fortë ndërkombëtare. Boris Jelcin i erdhi në ndihmë kolegëve të tij jugosllavë dhe bëri që, nëpërmjet ministrit të tij të Punëve të Jashtme, të shpallej një “Njet” (“Jo”), i dyfishtë. Moska i tha jo një shkëputjeje gjithmonë më të stërholluar të Kosovës nga Serbia, sepse kjo do të shpinte në gjakderdhje dhe në luftë. Vetëm një autonomi e Kosovës, e përkufizuar jo shumë hollësisht do të ishte zgjidhja. “Njeti” (“Jo-ja”) i dytë kishte të bënte me vënien në përdorim të dhunës ushtarake nga ana e Bashkësisë Ndërkombëtare. Kosova ishte çështje e brendshme e Jugosllavisë dhe dhuna do të mund të ushtrohej vetëm me miratimin e Beogradit.

Si dhe në luftën e Bosnjes, Moska e ndjente veten të detyruar që, ose të ushtronte një ndikim zbutës në Beograd, ose të përpiqej të vendosej paqja. Është e vështirë të kuptohet se pse Perëndimi iu drejtua Rusisë, megjithëse duhet ta dinte se ofensiva serbe në Kosovë, nën muzikën shoqëruuese të fyejve të paqes së Moskës edhe më energjikisht do të shkonte përpara. Millosheviçi shfrytëzoi këtë kohë pushimi që e fitoi me ndihmën e Moskës dhe dërgoi në korrik të vitit 1998, formacione të freskëta të ushtrisë dhe të milicisë serbe në Kosovë. Për të qetësuar

⁴ “The New York Times”, 8 mars 1998.

opinionin publik ndërkombëtar ai deklaronte nga koha në kohë se ofensiva kundër terroristëve shqiptarë ishte para mbylljes përfundimtare. Nuk mund t'i shmangesh përshtypjes se Millosheviçi, për aksionet ushtarake në Kosovë, kishte marrë miratimin e heshtur të Moskës.

Në Perëndim dendësoheshin zërat e politikanëve që thonin se Moska duhet të vijë së fundi “në një barkë me ne”. Njëkohësisht, ishte e padyshimtë se Rusia dhe shtetet evropiane të NATO-s, problemin e Kosovës e shihnin nga pikëpamje krejt të ndryshme. Ndërsa Moska hidhte poshtë prerazi çdo ndërhyrje, NATO-ja ndërtonte gjithmonë e më shumë kulisa kërcënuese dhe demonstronte nëpërmjet manovrave të forcave ajrore në Maqedoni dhe në Kosovë vendosmërinë e saj për të ndërhyrë. Në tetor të vitit 1998, Riçard Holbruk, me urdhërin e ndërhyrjes së NATO-s në xhep, nuk arriti ndonjë rezultat në tratativat e tij për paqe me Slllobodan Millosheviçin. Në vitin 2000 u desh të dërgoheshin në Kosovë të ashtuquajturit OSBE-verifikatorë – vëzhgues të paarmatosur. Ata duhej të mbikqyrnin armëpushimin dhe kthimin e refugjatëve. Në Maqedoni qe vendosur një e ashtuquajtur “Extraction Force”, një trupë ndërhyrëse prej 1 700 vetash, e caktuar për vëzhguesit e OSBE, me helikopterë dhe njësi tankesh që në rast nevojë t'i nxirrin nga Kosova. Njëkohësisht marrëveshja parashikonte që aeroplanë zbulimi të NATO-s të fluturonin mbi Kosovë në kuadrin e operacionit “Eagle’s Eye” (“Syri i Shqiponjës”)⁵.

Rambuqe (Rambouillet)

Meqë dhuna dhe terrori në Kosovë edhe në fillimin e vitit 1999 vijonin e nuk po dukej kurrfarë gatishmërie për pajtim, Grupi i Kontaktit vendosi që në muajin shkurt të ballafaqonte qeverinë serbe dhe krerët shqiptarë të Kosovës me një diktat paqeje të supozuar. Palët e armiqësuar duhet të shkonin në kështjellën Rambuqe, ku brenda një periudhe dyjavore të merreshin vesh për një zgjidhje për Kosovën. Baza e bisedimeve ishte plani i paqes i të dërguarit të posaçëm amerikan Hill, në versionin e tij të tetë a të nëntë.

Që në fillim, palëve në konflikt u qe bërë e qartë se tetëdhjetë përqind e pikave të marrëveshjes së paqes të parashtruar, nuk ishin të diskutueshme dhe duhet të nënshkruheshin pa ndryshime. Vetëm 20%

⁵ M.J. Calic, *Die Jugoslawienpolitik des Westens seit Dayton*, “Aus Politik und Zeitgeschichte, B34/99, 20 gusht 1999, f.22-23.

mund të konsideroheshin si material që mund të diskutohej. Përcjellës i këtij mesazhi ishte ministri i Punëve të Jashtme të Anglisë, Robin Cook, i cili u paraqit në një rol të dyfishtë. Si përfaqësues i Grupit të Kontaktit të Ballkanit, ai ishte për planin e paqes, si përfaqësues i NATO-s ai kërcënonte me sulme me bomba. Pas ministrit francez të Punëve të Jashtme Vedrine, Cook ishte në funksionin e mikpritësit të dytë të Konferencës. Franca dhe Britania e Madhe ishin paracaktuar që të luanin rolin udhëheqës ushtarak gjatë vënies në jetë të planit të paqes. Londra me 6 000 dhe Parisi me 5 000 ushtarë, duhej të jepnin kontigjentin më të fortë, ndërsa 2 000 – 4 000 ushtarë të ShBA duhej të ishin të pranishëm në trupat e paqes.

Udhëheqja e Beogradit kishte ngurruar për një kohë të gjatë para se të ishte gati për dërgimin e një delegacioni prej dy vetësh, përbërja e të cilit të bënte të mos parandjeje asgjë të mirë. Sllobodan Millosheviçi nuk erdhi në Rambuje, por as edhe presidenti serb nuk bëri pjesë në delegacion në fillimin e punimeve. Ai që shoqëruar nga juristi kushtetues Ratko Markoviç, të cilit i rrinin pranë katër politikanë të tjerë të një përmase dytësore. Tetë anëtarë të tjerë të delegacionit ishin dekorori folklorik i delegacionit. Këta njerëz, krejt të panjohur dhe të parëndësishëm, ishin në funksionin e përfaqësuesve të grupeve të shkëputura në Kosovë. Kështu “djepi i serbizmit”, siç vërente ironikisht revista “Obzor”, në Rambuje që mbrojtur edhe nga një kroat nga Spliti. Ky njeri quhej Vladimir Stamuk dhe mbahej si jugosllav. Krahas me romët dhe goranët (një grup i vockël sllavësh të islamizuar) ishin të përfaqësuar me Qerim Abazin, edhe të ashtuquajturit egjiptianë, që në të vërtetë janë romë. Rrumbullakosur, spektri përbëhej nga pak shqiptarë besnikë të regjimit dhe nga turku Zejnelabedin Kurejshi⁶. Në këtë mënyrë Millosheviçi, njeriu i fortë i Serbisë dhe përgjegjësi kryesor i luftës në Kosovë dha të kuptojë mospërfilljen e tij, duke dërguar një delegacion të klasit të tretë. Më vonë ai dërgoi në Rambuje presidentin Milutinoviç, por kjo nuk ndryshoi asgjë.

Në delegacionin shqiptar prej katërmbëdhjetë vetësh qenë përfaqësuar tre grupime. Lidhja Demokratike e Kosovës me në krye Ibrahim Rugovën, ndjekur nga kryeministri Bujar Bukoshi që jetonte në mërgim dhe tre funksionarë të tjerë të LDK. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dërgoi pesë përfaqësues dhe caktoi në mënyrë të habitshme

⁶ “Neue Zürcher Zeitung”, 1 shkurt 1999.

tridhjetëvjeçarin Hashim Thaçi, madje kryetar të delegacionit. H. Thaçi i cili kishte studiuar shkenca politike në Zyrih, mbahej si ideologu i UÇK dhe ishte në lidhje të ngushtë me Partinë Socialiste të Shqipërisë. Titulli i tij zyrtar ishte “Komandant i udhëheqjes politike të UÇK”, (pas Konferencës së Rambujesë, njeriu me emrin e luftës (nom de guerre) “gjarpëri” qe ngritur në rangun e një kryeministri të Qeverisë Provizore të Kosovës). Jakup Krasniqi, si zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare ishte një përfaqësues tjetër i shquar i UÇK. Tre delegatë të pavarur dhe katër pjesëtarë të “Lëvizjes së Bashkuar Demokratike” të Rexhep Qoses plotësonin delegacionin. Përfaqësuesi kryesor politik i UÇK, Adem Demaçi, i njohur si Nelson Mandela shqiptar, sepse ka përjetuar plot 28 vjet burg, bojkotoi Konferencën. Duke i bërë thirrje Sekretares Amerikane të Punëve të Jashtme dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, ai u përpoq më kot të trazonte ujërat në një drejtim të caktuar. Pak kohë pas Konferencës ai humbi postin e tij në UÇK. I pranishëm në delegacionin shqiptar ishte edhe Azem Syla, një personalitet misterioz me nofkën “Xhaxhai i madh”. Ai mbahej si njeriu i fortë në plan të dytë, aq më tepër sepse ishte xhaxhai prej një gjaku i Hashim Thaçit⁷.

Takimi në Rambuje duhej të orientohej sipas modelit të Konferencës së Deitonit, që i kishte dhënë fund luftës në Bosnje. Një kulisë kërcënuese gjiganteske ushtarake kishte si detyrë, para së gjithash, të ushtronte presion te serbët, duke i detyruar të nënshkruanin. Kishte më shumë se 400 aeroplanë gjuajtës-bombardues të tipit të fundit, si dhe trupa ekspeditash ajrore që në çdo kohë mund të viheshin në veprim nga anijet e luftës në Mesdhe. Por Rambuje nuk qe si Deitoni. Në Bosnje kroatët dhe myslimanët e bashkuar me ta, i kishin shkaktuar humbje të rënda trupave serbe. Pastaj erdhën goditjet ajrore shkretuese të NATO-s me anën e të cilave qenë shkatërruar të gjitha rrugët e komunikacionit të ushtrisë serbe.

Në verën e vitit 1998 ushtria serbe në Kosovë e kishte dëbuar UÇK deri në Shqipërinë e Veriut. Te serbët nuk kishte aspak shenja lodhjeje dhe zhgënjimi. Përkundrazi, dukej sikur pas mbarimit të dimrit, duke u bazuar në epërsinë e vet, një betejë e re me UÇK do t'i garantonte fitoren përfundimtare.

⁷ “Ozbor”, Zagreb, 27 shkurt 1999.

Delegacioni serb në Rambuje iu përmbajt pikëpamjes së vet se një trupë paqeje e NATO-s në Kosovë ishte e papajtueshme me sovranitetin dhe integritetin tokësor të Jugosllavisë. Vetëm dy ditë para fillimit të Konferencës në Rambuje, parlamenti serb kishte miratuar vendime në lidhje me “agresionin kërcënues të NATO-s” dhe me kërkesat e ngritura në lidhje me këtë nga Grupi i Kontaktit. Atje thuhej se prania e ushtarëve të huaj në territorin serb nuk do të tolerohej në asnjë rrethanë⁸.

Delegacioni serb shpresonte se NATO me kërcënimet e saj donte ta shtynte Beogradin të ndërronte mendim, por gjithashtu mendonte se ato nuk do të viheshin në jetë. Nga shtetet anëtare të NATO-s, grekët ishin fuqimisht kundër bombardimeve, ndërsa italianët, gjermanët, francezët dhe madje, anglezët shprehnin dyshime për sulmet nga ajri, në se do të sillnin ndonjë rezultat. Së fundi, ky kërcënim qëndronte pezull mbi serbët që nga tetori i vitit të shkuar. Ata ishin të bindur se aeroplanin e çmuar Mig-29 dhe mjetet e tjera të shumëvlershme ushtarake i kishin vendosur në pika të sigurta. Materialin luftarak që e kishin pasur të strehuar në vende jo të sigurta nga bombardimet e kishin çuar fshehurazi në vende të tjera. Një ekspert ushtarak gjerman tha se goditjet ajrore ishin një lojë me rastësinë, duhet të kishe fat që të arrije të godisje objekte të rëndësishme. Vetëkuptohet se nuk mund të shpërfillëshin efektet shkretuese të avionëve ajrorë dhe të bombave, por nuk ishte e sigurtë nëse goditjet nga ajri do të mund të shkaktonin një ndryshim rrënjësor tek udhëheqja e Beogradit.

Konferenca e Deitonit dështoi për faktin se NATO-ja nuk kishte më në dispozicion kërcënime të besueshme. Në tetor të vitit 1998 kishte kaluar çasti kur goditjet nga ajri mund të kishin ende diçka për të shkaktuar. Meqë ishte bërë e qartë se serbët nuk do të frikësoheshin, qe një gabim zgjatja dy herë e Konferencës. Së fundi, qarqet e NATO-s nuk e ndienin veten fatkeqë që jo-ja e ndërkohshme e delegacionit shqiptar jepte një arsye të mirë që përkohësisht të hiqej dorë nga sulmet ajrore.

I parë në tërësi bilanci i Konferencës së Rambujesë ishte krejt ndryshe nga ai pozitiv. Për shtatëmbëdhjetë ditë rresht u zhvilluan bashkëbisedime, ku delegacionet folën vetëm me ndërmjetës, dhe jo me njëri-tjetrin. “Konsensusi” që u arrit më së fundi përbëhej nga një letër që të dy palët, të veçuara, i kishin dërguar Grupit të Kontaktit. Pala shqiptare deklaronte se mund të pranonte në parim planin e paqes, por duhej të

⁸ “Službeni Glasnik Republike Srbije”, nr.4, 4 shkurt 1999.

konsultohet me bazën e saj në Kosovë si dhe me disa ekspertë. Delegacioni serb shkruante në letrën e vet se ai mbështeste autonominë e Kosovës, në qoftë se kjo nuk shkonte deri në pavarësi, ose në një republikë të tretë në kuadrin e Federatës Jugosllave.

Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Milutinović shprehu menjëherë, pas përfundimit të palavdishëm të Konferencës së Rambujesë, një qëndrim që nuk linte gjë të paqartë. Ai pohonte se Konferenca, qoftë për përmbajtjen, qoftë për procedimet e saj praktike, nuk qe e organizuar mirë. Pastaj ai e mallkoi të gjithë Konferencën: *“Është bërë një mashtrim i pashembullt. Nuk donin të arrihej asnjë marrëveshje. E gjithë shfaqja qe organizuar me qëllimin që ne të prananim të papranueshmen, ose nëse nuk e prananim, si pasojë, të vinin bombat. Në fund të fundit, ne u gjendëm në një dilemë të papranueshme që më parë. Ne duhet të zgjidhnim ndërmjet bombave, nëse nuk prananim një marrëveshje të keqe, dhe trupave për një marrëveshje më të mirë, por po njëjloj të lidhura me krijimin e bërthamës të një shteti të ardhshëm në Kosmet”*⁹.

Ky qëndrim e bën të qartë se Konferenca nga perspektiva serbe ishte një ndërmarrje tërësisht e dështuar. Nga pikëpamja Perëndimore vijonin përpjekjet që Konferencën ta paraqitnin si një sukses. Kështu ministrat e Jashtëm të Grupit të Kontaktit deklaruan se bisedimet shtatëmbëdhjetëditore kishin sjellë një “përparim substancial”, vetëm se nuk ishte arritur që të dy palët pjesëmarrëse në konflikt të shtyheshin drejt nënshkrimit¹⁰. Është e qartë se diplomatët janë në pozitë më të mirë se njerëzit e ekonomisë. Sikurse të vinte përfaqësuesi i një ndërmarrjeje nga një udhëtim jashtë shtetit me mesazhin gazmor se kishte mundur ta bindte plotësisht partnerin, veçse nënshkrimi nuk ishte bërë, sigurisht, ai do të bëhej qesharak.

Me gjithë zbulimet, nuk mund të fshihej se NATO-ja në Rambuje kishte humbur në mënyrë të ndjeshme në besueshmëri, po ashtu si dhe “Ledi e hekur”, Madlen Ollbrajt (Madeleine Albright). Me kërcënimet e pamenduara mirë gjatë Konferencës, ajo vetëm arriti që respekti, që zakonisht shfaqej për politikën e jashtme amerikane, të bjerë në mënyrë të dukshme. Sekretarja e Punëve të Jashtme u përpoq t'i përmbahej parullës pak të ndryshuar të presidentit Ruzvelt (Roosvelt):

⁹ Erklärung von Außenminister Milutinović vom 23.02.1999, wie sie von den diplomatischen Auslandsvertretungen der SRJ verbreitet wurde.

¹⁰ “Financial Times”, 24 shkurt 1999.

“Speak loudly and carry a big tomahawk!” (“Fol me zë të lartë dhe ki me vete një sëpatë të madhe!”)¹¹.

Konferenca pasuese e Parisit solli po-në e delegacionit shqiptar për planin e paqes të bashkësisë ndërkombëtare dhe po-ja shqiptare për paqen bënte të mundshme luftën ajrore kundër Jugosllavisë. Koncepti i Perëndimit tregonte tri dobësi elementare. Njëri parashikonte se qeveria serbe do të gjunjëzohej para një ultimatumit, do të lejonte një trupë të paqes në Kosovë, do të hiqte dorë *de facto* nga sovraniteti dhe integriteti tokësor i vendit të vet. Asnjë politikan nuk mund ta bënte një gjë të tillë pa humbur në këtë lojë gjithë prestigjin e tij. Por edhe sikur të jepej miratimi serb, nga kjo nuk do të vinte kurrfarë autonomie, veçse, ashtu siç i jepet një pakice nga shumica. Kosova do të ishte atëherë si dhe sot, në thelb, një protektorat i NATO-s. Me këtë, do t'i shkëputej në shumë drejtime mundësive të ndikimit nga ana e Beogradit.

Dobësia e dytë e konceptit qëndronte në faktin se mund të jepej vetëm një autonomi shtetërore me të vërtetë demokratike. Serbia, si diktaturë me media të ndara në mënyrë të barabartë, me universitete jo të pavarura dhe mekanizma politike pseudodemokratike, ishte e papërshtatshme për këtë rol. Për këtë arsye edhe koncepti i Perëndimit ishte skajshmërisht i dyshimtë. Ajo që ishte thënë fillimisht se Kosova, për hir të parimit të paprekshmërisë së kufijve, duhej që të mbetej përgjithmonë në lidhjen shtetërore serbe. Ky koncept do të ishte i arsyeshëm, nëse mund të parashikonim se Serbia, brenda marrjes së vendimit përfundimtar mbi statusin e Kosovës, që në Rambuje ishte parashikuar për tre vjet, do të shndërrohej në një shtet demokratik. Për një zhvillim të tillë që, natyrshëm, do të vijonte shumë më gjatë sesa tre vjet, nuk kanë ekzistuar dhe nuk ekzistojnë as edhe pikënisjet më modeste.

Dobësia e tretë qëndronte në faktin se lidhja më e fortë ushtarake e botës, NATO, në mosmarrëveshjet me një shtet ballkanik të rangut të tretë, kishte manovruar në një situatë të tillë në të cilën lufta mbetej opsioni i vetëm, po që se nuk do të donte të humbiste dinjitetin e vet. Në këtë rast, Aleanca shmangte, po ashtu si dhe politikanët kryesorë perëndimorë, me kujdes, përdorimin e fjalës “luftë”. Goditje nga ajri, aksione ndëshkimore ose ndërhyrje, ishin termat e parapëlqyera. Është e dyshimtë se partnerët evropianë të NATO-s fillimisht nuk kishin bërë

¹¹ “Neue Zürcher Zeitung”, 6-7 mars 1999.

llogari zhvillimin e një lufte ajrore. Ata mendonin si sekretarja e Punëve të Jashtme amerikane, se Millosheviçi, pas tri ose katër ditëve bombardimesh të vazhdueshme, do të dorëzohej. Pra, nuk ishte parashikuar që presidenti jugosllav do të shihte me qetësi se si shkatërrohej infrastruktura e vendit të tij. Millosheviçi shpresonte se mund të përballonte luftën ajrore. Në qoftë se ai do të mbahej në fuqi për një kohë mjaft të gjatë, do të shkaktonte të çara në koalicionin armik të tij.

Fundi i luftës

Në retrospektivë, çështja vendimtare është: për ç'arsye Millosheviçi, pas 11 javësh lufte ajrore u dorëzua? Gjunjëzimi i tij nuk ishte rezultati logjik i një taktike të pagabueshme të NATO-s. Ai mund ta zgjaste këtë luftë edhe katër javë të tjera, por nuk do të mund ta fitonte kurrë.

Në shtator të vitit 1999, "Herald Tribune International" parashitroi tezën se pas nëntë javësh luftë ajrore NATO-ja, qysh në fund të majit të vitit 1999, kishte ardhur në përfundimin se pushtimi i Kosovës me trupa tokësore nuk mund të shtyhej për më vonë. Nëse trupat tokësore ishin mjeti i vetëm për të fituar këtë luftë, ato duheshin vënë në veprim. Më 27 maj 1999, u takuan në mënyrë sekrete në Bon, ministrat e Mbrojtjes të ShBA, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë e të Italisë dhe arritën në mendimin e përbashkët se qeveritë e tyre brenda tri ditëve duhej të vendosnin për trupat tokësore. Plani parashikonte që më 1 qershor të merrej vendimi për trupat tokësore, të cilat do të viheshin në përdorim më 1 shtator.

Më 2 qershor, këshilltari i presidentit Klinton për sigurimin, u takua me ekspertë amerikanë për politikën e jashtme. Ai nuk e fshehu se përdorimi i trupave tokësore ishte një mundësi reale. Pak kohë më parë ai kishte mundur të bindte Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Havier Solana, se i duhej t'i hapte dritën jeshile kryekomandantit të Aleancës, Uesli Klark, për bisedime të fshehta në lidhje me përdorimin e trupave tokësore¹².

Sido që të ketë qenë planifikimi i NATO-s në gjëra të veçanta, ka mundësi që Millosheviçi të kishte besuar në përdorimin e afërm të drejtpërdrejtë të trupave tokësore. Njëkohësisht, atij, gjoja i qe sugjeruar

¹² "International Herald Tribune", 20 shtator 1999.

nga shërbimet e fshehta perëndimore, se trupat nuk do të ndaleshin në kufijtë e Kosovës, por do të marshonin në drejtim të Beogradit. Pas marrjes së Beogradit, transferimi i presidentit jugosllav në Gjykatën e Hagës do të ishte hapi tjetër logjik. Nëse kjo tezë do të ishte me vend, ajo do të jepte një shpjegim bindës për të gjithë vëzhguesit në lidhje me dorëzimin e habitshëm të Millosheviçit.

Në qoftë se bëjmë një bilanc të luftës ajrore nga NATO-ja kundër Jugosllavisë, të filluar më 24 mars, mund të thuhet se metoda e zgjedhur, domethënë shkatërrimi pak a shumë tërësor i infrastrukturës jugosllave, nuk mund të ishte mjete i përshtatshëm kundër një diktatori të paskrupullt. Në këtë mënyrë, vetë diktatorin nuk mund ta prekje, viktimat e tij në Kosovë nuk mund t'i ndihmoje drejtpërsëdrejti. Popullsia serbe kishte viktimat civile për të vajtuar. Akoma dhe për shumë vjet do të vuante nga shkatërrimi i urave, rrugëve, hekurudhave dhe centraleve elektrike. Ushtria jugosllave, të cilën përmes luftës ajrore donin ta dobësonin ndjeshëm, pësoi në 11 javët e luftës humbje të pakta. Por tri qëllime të luftës qenë arritur:

- 1 - Tërheqja e plotë e trupave serbe nga Kosova.
- 2 - Vendosja e trupave paqeruajtëse ndërkombëtare.
- 3 - Kthimi i të arratisurve, i refugjatëve në Kosovë.

Një qëllim tjetër thelbësor nuk qe arritur¹³. Pas luftës, më 18 qershor, Klintoni, presidenti i ShBA, deklaroi në Këln se është e mundur të ndërtohet një Kosovë shumëkombëshe. Kjo ishte një sfidë e madhe, por që mund të arrihej. Në këtë pikë bashkësia ndërkombëtare ka pësuar një dështim të ndjeshëm, një dështim që vështirë se mund të shlyhet¹⁴. Vlerësime të kujdesshme, thonë se të paktën gjysma e popullsisë jomyslimane (më shumë se 100 000 njerëz), ndërmjet mesit të qershorit dhe fundit të tetorit 1999, e kanë braktisur Kosovën, pasi qenë dëbuar prej andej. Nuk u arrit që të ndalej dhuna. Tani ishin serbët, romët, në një masë më të vogël myslimanë dhe në raste të pakta, bile edhe shqiptarë të krishterë viktimat të vrasjeve, zjarreve, rrëmbimeve, lëndimeve trupore dhe kërcënimeve masive. Popullsia joshqiptare u arratis, nga njëra anë nga ankthi i zemërimit të shqiptarëve që ktheheshin, ndërmjet të cilëve kishte nga ata që donin hakmarrje, nga ana tjetër, nuk ka dyshim, se aktet

¹³ Vgl. zu den Menschenrechtsaspekten insgesamt auch den vorliegenden Aufsatz von Fabian Schmidt.

¹⁴ Kosovo-Official U.S. Government Documents, www.usia.gov/regional/eur/balkans/kosovo/ausio.htm, 18 qershor 1999.

e dhunshme kundër serbëve dhe romëve qenë të organizuara për t'i detyruar ata të braktisnin vendin e tyre¹⁵. Shoqëria shumëkulturore në Kosovë është shkatërruar. Të gjitha sigurimet e përfaqësuesve të atjeshëm të bashkësisë ndërkombëtare, se do t'i përmbahen karakterit multikombëtar të provincës tingëllojnë bosh, kur krahasohen me faktet.

Veton Surroi, botuesi i gazetës së përditshme kosovare “Koha Ditore”, shkruante në gusht të vitit 1999: *“Unë duhet të pohoj. Unë kam turp nga vetja. Unë turpërohem kur shoh se ne, shqiptarët-kosovarë, për herë të parë në historinë tonë, jemi të aftë të bëjmë bëma të tilla të përbindshme. Unë njoh, natyrisht shfajësimin e dukshëm se ne kemi kaluar përmes një luftime barbare, në të cilën serbët kanë bërë krime të neveritshme. Intensiteti i dhunës të shumë shqiptarë ka lindur dëshirën për të marrë hak. Por kjo nuk është për ligjë. Dhuna e sotme, më shumë se dy muaj pas ardhjes së trupave të NATO-s, është më shumë se vetëm një reagim intelektual. Kjo është një frikësim i organizuar dhe sistematik i të gjithë serbëve, nga shkaku i vetëm se serbët janë serbë dhe prandaj, bëhen përgjegjës për gjithçka që ka ndodhur në Kosovë. Ky është qëndrim fashist”*¹⁶.

Karakterit pa shpresë i situatës së krijuar theksohet nga reagimi i forcave radikale në Kosovë ndaj këtyre fjalëve. Ato në mënyrë të tërthortë kanë bërë thirrje që të vritet Veton Surroi.

Gjendja politike dhe ligjore

Klima e intolerancës dhe e urrejtjes favorizohet nga fakti se shkelje të shumta të ligjit mbetën të pandëshkuara. Policia ndërkombëtare e Kosovës, e rekrutuar nga 42 kombe, përfshinte në dhjetor të vitit 1999 vetëm 1 900 nëpunës nga 6 000 që i qenë premtuar administratës civile të OKB për Kosovën (UNMIK). UNMIK-u mundi të paguajë mësues, mjekë e avokatë me pagesën minimale prej 300 marka gjermane dhe këto shpesh janë dhënë një herë në dy muaj. Në vitin 1999, UNMIK-ut i mungonin 25 milionë dollarë për të përballuar detyrat e veta. Buxheti për vitin 2000 llogaritej me një boshllëk prej 150 milionë dollarë. Siç ka vërejtur në mënyrë sarkastike një nëpunës i OKB, gjatë luftës ajrore

¹⁵ “Neue Zürcher Zeitung”, 11 janar 2000.

¹⁶ “Koha ditore”, 18 gusht 1999.

mund të përballoheshin me këto shuma modeste bombardimet vetëm të një gjysmë dite¹⁷.

UNMIK-u, i financuar kronikisht nën nevojat e tij, duhej të mbushte vakuumin e lënë nga serbët lidhur me autoritetin shtetëror. Në sferën policore UNMIK-u duhej jo vetëm të kujdesej për ligjshmërinë dhe rendin, por duhej të ndërtonte nga hiçi edhe shërbimin hetimor, ndjekjen penale dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore. Policia e OKB nuk është aspak e pajisur për mbajtjen e rendit gjatë demonstrimeve masive të dhunshme. Edhe lufta, gjithmonë në rritje kundër krimeve të rënda, zhvillohet me armë shumë të pabarabarta dhe prandaj është në një shkallë të madhe e pasuksesshme.

Dështimet gjatë përpjekjeve për të vendosur rendin dhe sigurinë janë simptomatike. Ato i përforcon fakti se bashkësia ndërkombëtare nuk ka ende një koncept të qartë për rendin e pasluftës në Kosovë. Në vija të përgjithshme kjo buron nga fakti se e ardhmja e provincës është krejt e paqartë. Sipas mënyrës zyrtare të të lexuarit, Kosova vijon të jetë gjithmonë pjesë e Jugosllavisë, *de facto* provinca është një protektorat ndërkombëtar me një të ardhme të pasigurt.

Sovraniteti jugosllav është pezulluar, shumë përfaqësues të UNMIK-ut përfaqësojnë së brendshmi mendimin se ai, *de facto*, është hequr. Në praktikë, Jugosllavia ende është kompetente për të gjitha çështjet e pasaportave. Megjithatë, shumë shqiptarë nuk pranojnë të kenë asnjë kontakt me autoritetet serbe.

Protektorati i Kosovës bazohet në bashkëpunimin ndërmjet UNMIK-ut, KFOR-it dhe OSBE. KFOR-i është përgjegjës për sigurinë e jashtme dhe pengimin e konflikteve të armatosura. UNMIK-u duhet të ndërtojë një administratë të përkohshme dhe të vërë në lëvizje proceset e domosdoshme politike dhe ekonomike¹⁸. OSBE, përkundrazi, duhet të organizojë zgjedhjet, të krijojë e të gjallërojë media të pavarura dhe të ndihmojë për ndërtimin e një sistemi demokratik.

Fillimisht, pas luftës, në Kosovë kishte tri qeveri të panjohura: qeveria e vetemëruar e Hashim Thaçit, qeveria e Ibrahim Rugovës dhe qeveria hije serbe që zgjaste afatin e ekzistencës së vet. UNMIK-u krijoi në radhë të parë Këshillin Kalimtar të Kosovës – Kosova Transitional

¹⁷ “International Herald Tribune”, 27-28 nëntor 1999.

¹⁸ Vgl. dazu auch den vorliegenden Aufsatz von Marie-Janine Alic zu den internationalen Bemühungen um den Wiederaufbau in Kosovo.

Council (KTC), ku përfshiheshin të gjitha grupimet e rëndësishme politike. Por ky Këshill ishte vetëm një organ konsultativ, pa ndikim të vërtetë. Bernard Kushner (Bernard Kouchner), ambasadori i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, krijoi më vonë, një lloj qeverie koalicioni me anën e një marrëveshjeje të arritur me vështirësi. Kryetari i qeverisë së përkohshme dhe kryetari i hershëm i UÇK, Thaçi, udhëheqësi i LDK dhe i rezistencës së dikurshme paqësore, Ibrahim Rugova si dhe Rexhep Qosja, kryetari i Lëvizjes së Bashkuar Demokratike, nënshkruan më 15 dhjetor të vitit 1999, këtë marrëveshje. Në këtë mënyrë lindi në fillim të shkurtit të vitit 2000, Këshilli i Administratës Kalimtare të Kosovës, i konceptuar si një qeveri e përkohshme (shoqëruar me vetëshpërndarjen e organit akoma ekzistues të qeverisë së shtetit hije të dikurshëm nën Rugovën, në 1 shkurt), të cilit, krahas me tre udhëheqësit shqiptarë të përmendur, duhet t'i shtohet edhe një serb, si dhe katër përfaqësues të UNMIK-ut. Këshilli do të mbledhet një herë në javë duke i marrë vendimet me shumicë votash. Në rastin e një situatë barazie, domethënë katër zëra kundër të katërve, vendoste Bernard Kushner, në duart e të cilit mbeteshin pushtetet ligjvënës dhe ekzekutivë. Do të ngriheshin 14 ministri si dhe degë të veçanta për politikën e brendshme dhe të jashtme. Në krye të çdo ministrie, qëndrojnë dy bashkëdrejtues, një i UNMIK-ut dhe një nga partitë politike pjesëmarrëse¹⁹.

Në shumë drejtime, situata në Kosovë të kujton fatin e kolonive afrikane në fazën e fundit. Edhe këtu, zotërinjtë kolonialistë deshën të ndërmermin një varg masash të karakterit politik, të cilat duhet të siguronin që Kosova, pas lënies së lirë do të ndiqte rrugën e drejtë. Më vonë, pas pavarësisë së dhënë, sipas të gjitha rregullave doli se ajo kishte zhvilluar një sistem krejt të ndryshëm politik nga ai që kishin dëshiruar zotërinjtë kolonialistë të dikurshëm. Tani Kosova në të vërtetë nuk është aspak koloni, por përfaqësuesit e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të OSBE-së janë të një mendimi për faktin se popullsia e Kosovës duhet të kalojë një proces afatgjatë edukimi dhe formimi në frymë demokratike, para se provinca mund të lihet në fatin e saj, domethënë që të mund t'i jepet pavarësia. Me siguri, nuk është aspak gjë e tepruar nëse themi se një proces i tillë zgjat 15 a më shumë vjet para se të mund të japë frutet e

¹⁹ Sh. Maliqi, *Chaos and Complexities in Kouchner's Kosovo*, në "Institute for War and Peace Report", nr.17, 14 janar 2000.

para. Periudha pesëvjeçare që përmendet shpesh është me siguri shumë e shkurtër.

Kështu, disa thonë se në Kosovë – jo vetëm për arsye teknike – nuk duhet të tregojmë një nxitim jashtë mase, kur është çështja për mbajtjen e zgjedhjeve të lira. Njëkohësisht, del se mund të mendohet që sovraniteti i përfaqësuesve të rinj të zgjedhur të popullit dhe të parlamentit duhet kufizuar. Me fjalë të tjera, një parlament i ri i zgjedhur nuk do të ketë të drejtën të shpallë pavarësinë shtetërore dhe të përcjellë jashtë me brohoritje trupat e paqes dhe administratën e OKB. Çështja është se, nëse do të ketë apo jo një konfrontim, a do ta deklarojnë forcat radikale shqiptare KFOR-in trupë pushtuese, duke e shpallur të padëshirueshme; dhe a do të cilësohet UNMIK-u si instrument i sundimit të huaj? Si do të jetë mundur dhe si do të duhet të reagohet ndaj një sfide apo një provokimi të tillë? Në çdo rast, Përfundimi duhet të gjykojë së pari për një pavarësi të Kosovës. Një proces mendor korrespondues ka filluar të instalohet që nga vera e vitit 1999 dhe duket se para së gjithash ka bërë përparime në Uashington. Ndoshta do të ketë një mundësi për të siguruar pavarësinë, por kjo sigurisht pas një kohe të caktuar. Kjo zgjidhje do të ofronte përfitimin që të shmangnim veprimet anësore të padëshirueshme të pavarësisë, sepse një shtet i pavarur, për Kosovën, do të kishte një ndikim të caktuar magnetik te shqiptarët e vendit fqinj, Maqedonisë. Kjo do të ishte, të paktën, jo e pamundshme.

S u m m a r y

THE POLICY OF THE INTERNATIONAL COMMUNITY IN KOSOVA IN THE 90-ies

In his study the German scholar Jens Reuter basing on the situation in former Yugoslavia, in the beginning of the 90-ies, puts in evidence that the International Community, USA and EU didn't value as much as was needed the fact that Milosheviç removed to Kosova and Vojvodina the autonomy, excluding them from rights given them by the Federative Constitution of the year 1974. Thus, passed over in silence this conspiracy with the idea that, allegedly, Kosova was considered as part of Serbia. This was also for the fact that it was considered as excessive to require from the Serbs to secure Kosova, and in addition to Kosova Bosnia, too.

The Republic of Kosova of the year 1991 was recognized only by the parliament of Tirana, while the Declaration of Edinburgh (December 1992) requested to be reestablished the “autonomy of Kosova inside Serbia” which presupposed that every thing could be resolved with “dialogue” and “measures creating confidence”. The European Union after the year 1992 was interested in the restraint of violence in Kosova, that’s why the non-violent policy of Ibrahim Rugova found moral support in the western world. This policy held for over 7 years calm a region which always was qualified as centre of war. The efforts of the Albanians and of I. Rugova didn’t achieve to internationalize the question of self-determination to such a degree that “Kosova – the foundling of Dayton” was not accepted neither in the Conference of Dayton in the year 1995.

Afterwards, all the efforts aimed at the improvement of the man’s rights in Kosova, which were violated continually by Belgrade and which much scruple.

Taking all that in consideration, the European Council addressed with an appeal to Belgrade asking for Kosova a “dimension of autonomy” without making any change in the territorial Status quo in the remained Yugoslavia. According to the author, this request would lead to the situation when, after the fulfilling of this request by Belgrade, Kosova would be called part of Yugoslavia, and the solution of the problems with it would be an inner question of Yugoslavia. And every request of the international factor would be called intervention in the inner affairs. The author mentions a very important fact: the Albanians considered the Serb army and police as occupier and their country as occupied zone. In these conditions the stands were diametrically opposed.

Differently from the states of the European Union, USA did not recognize Yugoslavia, but “Serbia and Montenegro”. There wasn’t embassy, supported the non-violent policies of I. Rugova, who was welcomed as guest some times in Washington. It set up even a wall which separated the state “Serbia-Montenegro” from the market of the international capital. The president Bush in the presidential confidential message for Christmas 1992, because of Kosova and the ethnic cleansing, menaced with air attacks of the USA against the strategic objectives in Serbia, and also military advance in Kosova, which were repeated also on February 10, 1993. Even in February 1998 was stressed the same stand. The minister of Foreign Affairs Albright, little later said: “We wouldn’t see passively how the Serb authorities do in Kosova what they are not able to do in Bosnia”.

In September 1997 the Contact Group took up for consideration the question of Kosova. It didn’t approve neither the violence of Serbia nor the request of the Albanians for independence, a thing stressed even in the Declaration of Moscow (1997), which condemns both the Serb brutality and the “terrorist” acts of UÇK (Liberation Army on Kosova). On the other side, the

sanctions of an economic character towards Yugoslavia didn't do it to withdraw from the followed policy. It was made clear by the EU and by numerous politicians – a second Bosnia would not be allowed. In a certain manner Miloshević found support only in Moscow, in June 1998, from Jeltsin, because he thought that the detachment would cause bloodshed, and would require the use of violence by the International Community. Miloshević strove to exploit it with reprisals allegedly, against the terrorists.

Having a clear idea of the reactions of Miloshević, Richard Hallbrook, with the order for intervention of NATO in the pocket, in October 1998 undertook some menacing actions, as, manoeuvres of the air forces in Macedonia and Kosova, negotiations for peace with Miloshević, sending of the observers of OSBE etc., which were without result. In Macedonia was established an intervention corps with helicopters, tanks and air scouts.

The Agreement of Rambouillet of the beginning of the year 1999 sought to accelerate the results. It had a two weeks term to sign the so much sought agreement between the Serbs and the Albanians. The peace agreement requested to the parties to discuss and to agree only for 20% of it because 80% were indiscutable, so it would be signed without changes. Robin Cook had a double role, as representative of the Contact Group of the Balkans and representative of NATO which menaced with bombs.

On the other side, the Serbs with Miloshević didn't value the participation. They sent four politicians of second-class with a folkloric decorum, with quite unknown men. Later on to Rambouillet went the president Milutinović.

The Albanians, with a delegation of 17 men, represented three groupings: the KDL with Ibrahim Rugova and Bujar Bukoshi, UÇK with Hashim Thaçi and Jakup Krasniqi, as well three independent delegates and four participants of the "Democratic United Movement" of Rexhep Qose. Adem Demaçi boycotted the conference.

The meeting of Rambouillet aimed at exerting pressure on the Serbs to give an end to the war, thus, to sign. Besides the caused damages by the war in Bosnia, the Serbs were menaced by more than 400 fighter-bombers of the last type as well by troops of air experts ready with the warships in the Mediterranean Sea.

The fact that the Serb army had suffered little damage and the UÇK retreated in North Albania, gave a certain security to the Serbs for a final victory. The Serbs were against the intervention of the foreign forces in the inner Yugoslav borders, that's why such a thing would not be tolerated by them. Their intention was to exert pressure towards the international forces to

withdraw from the idea of attacking Yugoslavia. This security was based also on their military force.

After 17 days of talks the Albanians accepted to sign the agreement, while Serbs came out with unclear stands, accusing the International Community. The Albanian “Yes” in the Conference of signature of Paris made possible the war from the air against Yugoslavia. In this manner NATO waged the war from the air, but with a difference from what was foreseen it didn’t last 3-4 days, which “would be sufficient to defeat Milosheviç”, who resisted longer with the hope that this would split the enemy coalition against him.

To the question why Milosheviç surrendered after 11 weeks of war from the air, when he could resist to NATO 4 other weeks, too, the author answers with the reasoning that already Milosheviç did understand that NATO wouldn’t withdraw; after the air attacks, it was now the turn of the ground forces, which were ready. Their putting into action was a question of time. For that the plans were already ready. Milosheviç was well-informed now that the troops of NATO would not halt in Kosova, but in Belgrade, thus the transfer of the Yugoslav president to the Hague Tribunal couldn’t be hindered by nothing. The aims of the war were achieved: a) the withdrawal of the Serb troops from Kosova; b) the establishment of the international peacekeeping troops; c) the coming back of the fugitives, of the refugees in Kosova.

After 18 June it was reached what declared president Clinton in Koln that “it is possible the construction of a multinational Kosova”. From the middle of June 1999 until October 1999 were expelled from Kosova more than 100 000 non-Moslems. “The fugitives went away for fear of revenge, - stresses the author, - but even by the pressure exerted on them by the Albanians to move away”. The author doesn’t leave without mentioning the fact that such actions of the extreme radical elements were not approved, moreover were condemned by the progressive part of the Albanian kosovar society.

The political situation in Kosova, the climate of intolerance was made possible by the lack of ability to applicate in due manner the law in Kosova. The great lack of the staff employees of UNO (from 6 000 promised were working 1 900). The low pays of the various employees as well the lack of 20 million dollars to face the needs created difficulties for the work of UNMIK. Even the future didn’t promise not up too much. For the year 2000 it was calculated a deficit in the budget of 150 000 000 dollars.

UNMIK had to begin all from the beginning, all from the law, for the legislation, the order, the investigative services, the courts etc. The grave crimes always growing and the numerous arms damaged the good developments of the activities of UNMIK. The official dependence for some questions of Kosova from Yugoslavia was in contradiction with the fact that it

was de facto international protectorate based on the cooperation of UNMIK, KFOR and OSBE which would lead Kosova towards independence even, why not, for a relatively long period, of 15-teen years, - concludes the author, convinced that the contradiction within it would be understated until to assure a normal coexistence.